



Datë: 24.11/2025
Numër Protokolli: 7541/2025

A.nr. 1877/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti, kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës me numër A.nr.1877/2025, të datës 06.11.2025, të parashtruar nga ankuesi N.H nga Prishtina, kundër organit të punësimit/Ministrit të Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “*Pezullim nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 24.11.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa, A.nr.1877/2025, e datës 06.11.2025 e parashtruar nga ankuesi N.H.

II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr.Prot: 7339-2/25, i datës 09.10.2025, i Divizionit të Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

A r s y e t i m

Ankuesi N.H (*tutje referuar vetëm ankuesi*), më datë 06.11.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.Prot: 7339-2/25, të datës 09.10.2025, të Divizionit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 7189/2025 të datës 06.11.2025, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Kopjen e ID-së së ankuesit; Vendimin me Nr. Prot:7339-2/25, të datës 09.10.2025, të Divizionit të Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; Vendimin A.nr.1559/2025 të KPMSHCK-së si dhe provat e administruara sipas Vendimit A.nr.1559/2025 të KPMSHCK-së si: Përgjigjen në ankesë e datës 19.08.2025; Procesverbal i datës 11.07.2025 nga Divizioni për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore; Formularin e përshkrimit të punës për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Raportimin dhe Kontabilitetin; Emailin e datës 04.07.2025 nga F.I për ankuesin; Emailin e

datës 04.07.2025 nga I.B për F.I; Emailin e ankuesit datës 03.07.2025, 19.06.2025, 12.06.2025, 10.06.2025; Vendimin me numër protokolli 6800/24 të datës 18.10.2024, Vendimit me numër protokolli 7543/24 të datës 15.11.2024, Vendimin me numër protokolli 1857/25 të datës 26.03.2025 dhe Vendimin me numër protokollo 2225/25 të datës 11.04.2025, për pezullimin e marrëdhënies së punës së ankuesit; Emailin e datës 13.06.2025 nga Administratori i Gjykatës Themelore në Prishtinë; Kërkesën e Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore të MMPHI të datës 12.06.2025 për Administratorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë; Njoftimet përmes emailit të datës 10.04.2025, 25.03.2025, 14.11.2024 nga Administratori i Gjykatës Themelore në Prishtinë; Dilemën me Nr. 632 të ankuesit; Akt Emërimit të datës 21.02.2022; Përshkrimin e punës për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Pagesa Ujore dhe Projekte; Vendimin me numër protokolli 6296/2025 të datës 23.09.2025 për zgjatjen e afatit për vendosje të ankesës së ankuesit; Emailin e datës 02.10.2025 nga A.B për H.K dhe B.Z; Njoftimin e datës 14.10.2024 nga Administratori i Gjykatës Themelore në Prishtinë; Emailin e datës 02.10.2025 nga A.B për Administratorin e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe Emailin e datës 02.10.2025 nga Administratori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.

Kolegji i Këshillit, bazuar në shkresat e lëndës konstatoi se ankesa është e pabazuar, **Sepse:**

Nga provat e administruara rrjedhë së ankuesi sipas Akt Emërimit AE.Nr.01/2022 të datës 21.02.2022, është i punësuar në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Pagesa Ujore dhe Projekte në Autoritetin e Rajonit të Pellgjeve Lumore në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Tutje sipas provave të lëndës, bazuar në njoftimin e datës 14.10.2024 të Administratorit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, lidhur me njoftimin se më datë 11.10.2024 është caktuar masa e paraburgimit për ankuesin, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e kësaj ministrie më datë 18.10.2024 ka nxjerr Vendim me numër protokolli 6800/24, me të cilin ankuesin e ka pezulluar nga marrëdhënia e punës për periudhën nga data 11.10.2024 deri më datës 09.11.2024 me 50% të pagës deri në fund të periudhës së pezullimit, dhe kështu ka ndodhur sipas Vendimit me numër protokolli 7543/24 të datës 15.11.2024 kur është pezulluar nga marrëdhënia e punës me 50% të pagës për periudhën nga data 11.11.2024 deri më datë 10.01.2025, pastaj sipas Vendimit me numër protokolli 1857/25 të datës 26.03.2024 është pezulluar nga marrëdhënia e punës me 50% të pagës për periudhën nga data 11.01.2025 deri më datës 06.04.2025, si dhe me Vendimin me numër protokolli 2225/25 të datës 11.04.2025 i njëjti është pezulluar nga marrëdhënia e punës për periudhën nga data 06.04.2025 deri më datë 06.06.2025.

Udhëheqësja e Njëjësë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, më datë 09.06.2025 ka kërkuar nga Administratori i Gjykatës Themelore në Prishtinë nëse ka ndonjë veprim apo vendim lidhur me çështjen e ankuesit, ndërsa Administratori i Gjykatës Themelore në Prishtinë më datë 13.06.2025, ka njoftuar se masa e caktuar ndaj palës ka përfunduar më datë 06.06.2025 dhe nuk është pranuar ndonjë kërkesë dhe nuk ekziston asnjë masë për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë.

Ndërsa ankuesi më datë 10.06.2025 dhe 12.06.2025, ka njoftuar ministrinë përkatëse se përderisa nuk ka ndonjë masë nga gjykata nuk ka pengesa ligjore për kthim në vendin e punës, kurse ankuesi më datë 04.07.2025 është njoftuar se do të kthehet në punë, e si rezultat i kësaj ushtruesi i detyrës së Sekretarit të

Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, më datë 11.07.2025 ka nxjerr Vendim me numër protokolli 5377/25 me të cilin ankuesin e ka transferuar në mënyrë të përhershme në pozitën Udhëheqës i Divizionit të Raportimit dhe Kontabilitetit.

Ankuesi në ankesën e parashtruar për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 5377/25, të datës 11.07.2025 për transferim të përhershëm, pretendon se i njëjti është në kundërshtim me dispozitat ligjore ngase nuk është konsultuar fare për këtë transferim për të marr miratimin e tij. Kërkon që i njëjtit të shfuqizohet dhe të kthehet në pozitën që ka mbajtur. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 03.10.2025 ka nxjerr Vendim A.nr.1559/2025, me të cilin kishte shfuqizuar Vendimin me numër protokolli 5377/25 të datës 11/07.2025 të ushtruesit të detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, dhe çështjen e kishte kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje te Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të kësaj ministrie.

Divizioni i Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me qëllim të zbatimit të Vendimit A.nr.1559/2025 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 09.10.2025, ka nxjerr Vendimin me Nr.Prot:7339-2/25, me të cilin ankuesin e ka pezulluar nga marrëdhënia e punës deri në vendosjen përfundimtare nga gjykata dhe atë me 50% të pagës.

Ankuesi në ankesën e parashtruar për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.Prot:7339-2/25, të datës 09.10.2025, të Divizionit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pretendon se sipas vendimit të KPMSHCK-së nuk është kërkuar pezullimi nga marrëdhënia e punës por vetëm është rekomanduar e që nuk është detyrim, nuk është aplikuar ky standard edhe për rastet e tjera, dhe po ashtu ky vendim nuk është arsye sipas nenit 38 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë. Vendimi nuk ka respektuar parimin e proporcionalitetit pasi që është marr masa e pezullimit që është masë ekstreme, dhe si i tillë nuk përmban arsyetim të mjaftueshëm. Kërkon që të konstatohet se vendimi i kundërshtuar është i kundërligjshëm dhe si i tillë të anulohet dhe të rikthehem në vendin e punës deri në përfundimin e procedurës penale duke respektuar parimin e prezumimit të pafajësisë.

Kolegji i Këshillit, lidhur me çështjen e pezullimit të marrëdhënies së punës së nëpunësit civil, ju referuar dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrarët Publikë, me theks të veçantë: **Nenit 68 paragrafi 1**, “1. Pezullimi është ndërprerja e përkohshme e marrëdhënies së punës në shërbimin civil që bëhet: 1.1. sipas detyrës zyrtare; 1.2. me kërkesë të nëpunëses/it civil”, **Nenit 69 paragrafi 1 dhe 2**,: “1. Nëpunësja/i civil pezullohet sipas detyrës zyrtare, në rastet si në vijim: 1.1. në rastin e procedurës disiplinore sipas paragrafit 4. të nenit 59 të këtij ligji; 1.2. kur emërohet në një nga funksionet e përcaktuara në paragrafin 1. të nenit 3 të këtij ligji, për periudhën përkatëse të emërimit; 1.3. transferohet, për nevoja të institucionit, në një organizatë ndërkombëtare apo në një institucion ndërkombëtar, për periudhën përkatëse; 1.4. kur gjykata pezullon nëpunësen/in civil që është person zyrtar nga ushtrimi i detyrës, për kushtet dhe shkaqet të parapara në legjislacionin përkatës në fuqi; 1.5. ndaj nëpunëses/it civil është iniciuar procedurë penale për kryerje të veprës penale gjatë ushtrimit të funksioneve të saj/tij; 1.6. nëpunësja/i civil, mbahet në arrest në pritje të vendimit të formës së prerë; 1.7. deklarohet e/i zhdukur me vendim të formës së prerë të gjykatës, deri në shfaqjen e personit apo deklarimit të vdekjes me vendim të formës së prerë të gjykatës;

1.8. regjistrohet apo zgjidhet, sipas ligjit, si kandidate për zgjedhjet qendrore e lokale, sipas nenit 25 të këtij ligji; 1.9. ndodhet në gjendje konflikti të vazhdueshëm interesi, sipas ligjit të veçantë, deri në transferimin e saj/tij në një pozitë tjetër, në përputhje me nenin 64 të këtij ligji; 1.10. gjatë ndjekjes së ndonjë programi arsimimi apo trajnimi më të gjatë se tridhjetë (30) ditë, për nevojat e institucionit, për periudhën që ndjek këtë program me shkëputje nga puna; 1.11. në raste të tjera, të parashikuara shprehimisht me ligj. **2. Përveç kur përcaktohet ndryshe me këtë ligj, konstatimi i shkakut të pezullimit bëhet nga: 2.1. NjMBNj e institucionit, ku nëpunësja/i ushtron detyrën”, Neni 71 paragrafi 8 dhe 9:** “8. Nëpunësja/i civil gjatë periudhës së pezullimit nuk përfiton pagë, me përjashtim në rastin e përcaktuar në paragrafin 1., nën-paragrafët 1.4., 1.5., 1.6. dhe 1.7. të nenit 69 të këtij ligji, nëpunësja/i civile përfiton pesëdhjetë për qind (50 %) të pagës së plotë, duke përjashtuar çdo lloj shtesë në pagë, deri në fund të periudhës së pezullimit. 9. Në rast se procedura disiplinore apo procedura penale përfundon pa një masë disiplinore, gjegjësisht dënim penal, nëpunëses/it civil që ka qenë e pezulluar me pesëdhjetë për qind (50%) të pagës së saj/tij, i kompensohet pjesa e ndaluar e pagës bazë”.

Kolegji i Këshillit, duke i shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit dhe duke e shqyrtuar ligjshmërinë e vendimit të kundërshtuar me ankesë respektivisht Vendimin me Nr.Prot:7339-2/25, të datës 09.10.2025, të Divizionit të Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, konstaton se në kohën kur është filluar procedura penale ndaj ankuesit e cila konfirmohet edhe nga njoftimi i datës 02.10.2025 i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, kanë qenë të aplikueshme dispozitat e nenit 69 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ku është përcaktuar se pezullimi sipas detyrës zyrtare ndaj nëpunësit civil aplikohet nëse ndaj tij është iniciuar procedurë penale për kryerje të veprës penale gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, e për rrjedhojë edhe përkundër faktit që ankuesi është pezulluar nga marrëdhënia e punës sipas Vendimit me numër protokolli 6800/24 të datës 18.10.2024, Vendimit me numër protokolli 7543/24 të datës 15.11.2024, Vendimit me numër protokolli 1857/25 të datës 26.03.2025 dhe Vendimit me numër protokollo 2225/25 të datës 11.04.2025, këto vendime kanë qenë ad hoc dhe nuk kanë qenë në pajtueshmëri me dispozitat e cekura si më lartë, sepse në rastet e tilla ankuesi është dashur të pezullohet nga marrëdhënia e punës deri në vendosjen përfundimtare nga gjykata.

Duke marr parasysh faktin se në kohën kur kanë filluar hetimet penale ndaj ankuesit nuk janë respektuar në plotësi dispozitat ligjore të aplikueshme, atëherë me qëllim të kthimit të ligjshmërisë siç është përcaktuar edhe me Vendimin A.nr.1559/2025 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga Divizioni i Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, janë ndërmarr veprimet e nevojshme ligjore lidhur me rastin e ankuesit, gjegjësisht sipas Vendimit me Nr.Prot:7339-2/25 të datës 09.10.2025 ankuesi është pezulluar nga marrëdhënia e punës deri në vendosjen përfundimtare nga gjykata dhe atë me 50% të pagës. Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, marrë parasysh dispozitat ligjore të cekura më lartë dhe duke marr parasysh faktin se ndaj ankuesit është duke u zhvilluar procedurë penale nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, atëherë Vendimi me Nr.Prot:7339-2/25, i datës 09.10.2025, i Divizionit të Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, është në pajtim me nenin 68 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nenin 69 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5, paragrafi 2, nenin 71 paragrafi 8 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, pasi që i njëjti përmban elementet e aktit administrativ si dhe është i arsyetuar si dhe dispozitave të nenit 47 respektivisht nenit 48 të Ligjit Nr. 05/L-197 për Procedurën e Përgjithshme Administrative,

kështu që edhe pretendimet ankimore për kundërligjshmëri të aktit të kundërshtuar me ankesë janë të pabazuara, sepse akti i kundërshtuar me ankesë nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore sipas pretendimeve të ankuesit, e për më tepër për rastin konkret nuk është i aplikueshëm neni 38 i Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sepse ky ligj nuk është në fuqi nga muaji shtator 2023, sikurse që me këtë ankesë nuk mund të trajtohen edhe rastet e tjera të pretenduara nga ankuesi, andaj përkitazi me konstatimet si në këtë vendim, Kolegji i Këshillit, konstaton se vendimi i kundërshtuar me ankesë është i bazuar në nenin 52 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ,andaj edhe si i tillë është lënë në fuqi.

Duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda:A.nr.1877/2025, datë 24/11/2025

Avdyl BEKTESHI

Arben MEHMETI

Procesmbajtës

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit N.A;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.